
	Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština - Municipality of Prishtina	
---	---	---

Datë/a:	27.11.2019
Për/ Za/ To:	MBB CONSTRUCTION
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj - Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit - Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 26.11.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "MBB CONSTRUCTION", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi dhe rethimi i varrezave të Komunes së Prishtinës", me Nr. të Prok: **616 19 059 521** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pa bazuar** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "MBB CONSTRUCTION", të dt. 26.11.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi dhe rethimi i varrezave të Komunes së Prishtinës", me Nr. të Prok: **616 19 059 521**, kundër **vendimit të Autoritetit Kontraktues**, të datës **21.11.2019** të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet vendimi i AK** për dhënien e kontratës të publikuar me datë: **21.11.2019**.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kerkesen me daten 27.11.2019 dhe ka konstatuar se e njejta eshte e pa bazuar.

Ankesa si e tille refuzohet pasiqe Autoriteti Kontraktues ka kryer rivleresimin sipas rekomandimit nga Vendimi i Panelit Shqyrtues te OSHP-se(citojme):

“Pra tek kriteri çmimi me i ulet me poentim Autoritetet Kontraktuese duhet eliminuar praktikat ku çmimet e njerit ofertues i krahason me çmimet e ofertueseve tjere,pasi qe kriteri i tille kerkon qe çmimet e poentuara te bazohen ne çmimin e ofertuar,e jo duke krahasuar çmimet me ofertuesit tjere,sepse ne rastet kur kemi krahasimin e çmimeve te ofertave te ndryshme me neyra tjetren atehere kemi te bejme me kriterin çmimi me i ulet ku edhe gjen zbatim Rregulla per tenderet abnormalisht te ulet,apo kur percaktojme kriterin ekonomikisht me te favorshem ku varesisht nga piket maksimale percaktohet fituesi,pra tek tenderi me çmimi me i ulet i poentuar per kontrate rekomandohet OE-ik i cili ofron çmimin me te ulet te poentuar pavaresisht çmimit te ofertes per njesi sepse kemi te bejme me kontrate kornize ku nuk kemi sasi indikative.”

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ate që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

